



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 19.08.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18.08.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “PM GROUP “ SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : “Furnizim me material higjenik për shkolla “ , Nr. i prokurimit- 632-22-5530-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-036-121, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “PM GROUP” SH.P.K., e dt.18.08.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material higjenik për shkolla “ , Nr. i prokurimit- 632-22-5530-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-036-121, kundër NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES , te AK –së, të datës 16.08.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë 16.08.2022;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.18.08.2022, Operatori Ekonomik "PM GROUP" SH.P.K., ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Furnizim me material higjenik për shkolla", Nr. i prokurimit- 632-22-5530-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-036-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 19.08.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti kontraktues Komuna e Gjakovës, konsideron se deklarata juaj e konfirmimitit nga prodhuesi është e mangët- përgjithshur dhe nuk është prezantuar ashtu siç është kërkuar në FDT, kurse Operatori ekonomik i shpërblyer me kontratë ka prezantuar një deklaratë të konfirmimitit nga prodhuesi të detajuar për secilin produkt dhe i ka plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit kontraktues në FDT-ë.

Pretendimi se Autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 39 të RRUOP –Sqarimi i tenderëve, duke mos kërkuar sqarime shtesë sipas nenit 72 të LPP-së. lidhur me certifikatën e TVSH-së, nuk qëndron, sepse kur një Operator ekonomik nuk plotëson një nga kërkesat në FDT-së, nuk kërkohen sqarime shtesë sipas nenit 72 të LPP-së.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës